



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

E.Rev.nr.2/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Millena Gjeriq anëtar, në kontestin sipas padisë së paditësit "B. B.." sh.p.k, me seli në P., të cilën me autorizim e përfaqëson Selim Nikqi dhe Emine Bajrami-Statovci, që të dy avokat nga P., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e avokatëve Sejdiu&Qerkini sh.p.k, me seli në P., për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 2.442.982€, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.462/2022, të datës 18.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i paditësit "B. B.." sh.p.k, me seli në P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.462/2022, të datës 18.05.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C. nr. 1686/11, të datës 28.12.2020, është refuzuar "si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "B. B.." sh.p.k, me seli në P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, që paditësit t'ia kompensojë dëmin material të shkaktuar me rrënimin e kundërligjshëm të objektit të pompës së benzinës, për shitjen e derivateve të naftës me pakicë, e cila ka qenë e ndërtuar në rr. "... " p.n., në P., pronë e paditësit dhe atë: në emër të fitimit të humbur për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të pompës së rrënuar, për periudhën prej datës 12.05.2010 deri me datën 28.04.2017, t'ia paguaj shumën prej 2,367,225.00€, dhe në emër të vlerës së objektit të rrënuar (lokalin afarist, rezervuarëve të derivateve, aparateve për toqitje dhe elementeve tjera përcjellëse), t'ia paguaj shumën prej 75,757.00€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2,442,982.00 €, me kamatë

ligjore, nga data 12.05.2010, krejt në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Detyrohet paditësi që të paditurës t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,690.00 Euro, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi".

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, me aktgjykimin e vet K.DH.SH.II.nr.462/2022, të datës 18.05.2023, ka vendosur që të refuzojë si të pabazuar ankesën e paditësit "B. B." sh.p.k, me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C. nr. 1686/11, i datës 28.12.2020, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësit, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi revizioni, të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, apo të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të anulohen, dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

E paditura përmes të autorizuarve shoqëria e avokatëve Sejdiu&Qerkini sh.p.k, me seli në P., ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit, dhe ka kërkuar që të refuzohet revizioni si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B. B., sh.p.k., në ngastrën kadastrale nr...., në të cilën ka qenë i ndërtuar objekti -pompa e derivateve, në rr. "...", ka ushtruar veprimtarinë afariste "tregtia me pakicë e vajrave". E paditura Komuna e Prishtinës me lejet e punës .. nr...., të datës 22.01.2009, dhe .. nr.... të datës 21.01.2010, i kishte dhënë leje paditësit për të ushtruar këtë veprimtari afariste për vitin 2009 dhe 2010, respektivisht deri më 22.01.2011.

Paraprakisht, e paditura Komuna e Prishtinës me procesverbalin ..., të datës 19.01.2009, kishte dhënë pëlqimin për lokalin afarist B. B. sh.p.k, në P., rr. "...", njësia nr., i cili, sipas këtij procesverbali të komisionit - inspektorëve të tregut, i plotësonte

kushtet minimale teknike, sanitare dhe mbrojtëse për zgjerim veprimtarie. E paditura më dt. 10.02.2009, përmes njoftimit e informon paditësin se procesverbali i lartcekur është jo valid dhe anulohet, për shkak se është bërë gabim teknik dhe se në lokacionin e lartpërmendur nuk mund të ndërtohet pompa e benzinës - pika shitëse e karburanteve por ekziston vetëm shitore për shitje - tregti me pakicë të lubrifikanteve - vajrave motorike dhe se fjala karburante nuk ekziston në pëlqimin e lëshuar për shitore. Sipas kërkesës së pronarit të paditësit, U. M., e paditura me vendimin nr. dt.15.05.2010, e refuzon kërkesën për dhënien e lejes së punës për zgjerimin e veprimtarisë me shifrën- tregtia me pakicë e karburanteve, për objektin lëndor që gjendet në rr. "...".

Ndaj vendimit të lartcekur, ankesë parashtron pronari i paditësit, në Inspektoratin e Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI). MTI, duke vepruar si organi administrativ i shkallës së dytë, me vendimin Ref. Nr. dt. 04.05.2010, e aprovon ankesën e paditësit, ashtu që e detyron organin përkatës të paditurës - Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, që në ri procedurë të rishqyrtojë vendimin.

Më dt. 31.08.2010, Inspekcioni i ndërtimit, i të paditurës, me aktvendimin tjetër .. Nr...., e urdhëron pronarin e paditësit që "menjëherë" të bëjë rrënimin e lokalit afarist, pasi që është ndërtuar pa leje (vendimi i dytë i Komunës për rrënimin e objektit). Ndërsa, Inspektorati komunal më dt.30.08.2010, me aktvendimin .. nr.... e urdhëron paditësin të bëjë largimin e pompave dhe rezervuarëve nga nëntoka të vendosura pa leje. Me vendimin Nr. A-..., të datës 14.09.2010, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e anulon aktvendimin e të paditurës .. Nr...., të datës 11.05.2010, me të cilën paditësit iu kishte urdhëruar rrënimi i objektit.

Kundër aktvendimit të lartcekur të MMPH, nr. A-.... të datës 28.10.2010, si akt administrativ, padi për konflikt administrativ ka paraqitur Komuna e Prishtinës, në gjykatën themelore në Prishtinë -Departamenti Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr. 39/11, të datës 14.11.2013, kjo gjykatë ka vërtetuar faktin se padia e lartcekur e konfliktit administrativ e Komunës së Prishtinës ishte aprovuar ashtu që, gjykata e ka anuluar aktvendimin e MMPH, nr. A-... të datës 28.10.2010.

Gjykata shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se paditësi nuk ka qenë e pajisur me leje të punës, nuk përbën bazë në kërkesën e saj për shpërblimin e dëmit. Se paditësi ka

pasur leje të punës për të operuar si veprimtari afariste në tregun e derivateve, për shitjen me pakicë të vajrave, jo vetëm se nuk është fakt kontestues, por as nuk paraqet arsye në përmbushjen e ndonjë kushti ligjor për shpërblimin e dëmit. Kjo për faktin se shkak i dëmit të pretenduar nuk ka qenë posedimi apo jo i lejes së punës, por rrënimi i objektit - pompës së derivateve të paditësit. Ndonëse në procedurën e brendshme administrative këto dy faktorë, posedimi i lejes adekuate të punës dhe rrënimi i objektit, mund të kenë pasur lidhshmëri juridike me njëra tjetrën, Gjykata në procedurë kontestimore nuk mund të lëshohet në vlerësimin e vendimeve të organeve administrative.

Sipas kushteve të lartcekura për ekzistimin e dëmit sipas fajit, në mënyrë që e paditura të përgjigjet për veprimin dëmtues të shkaktuar duhet që këtë dëm ta ketë shkaktuar në mënyrë të kundërligjshme. Në rastin konkret, në mes të palëve është zhvilluar një procedurë administrative për lejen e ndërtimit, dhe konflikti administrativë me padi në Gjykatën Themelore Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, e cila Gjykate me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.39/11, të datës 14.11.2013, është aprovuar padia e Komunës së Prishtinës dhe është anuluar aktvendimi i lartcekur i MMPH, nr. A-... i datës 28.10.2010. Me këtë aktgjykim, vendimet e MMPH, për anulimin e vendimeve të paditurës, sipas të cilave ka ardhur deri te rrënimi, janë anuluar dhe juridikisht nuk prodhojnë efekt juridik. Sipas vlerësimit të gjykatës, qëndron fakti se vendimet e lartcekura të Komunës së Prishtinës janë anuluar me vendimet e MMPH (Nr. A-... I datës 14.09.2010 dhe Nr. A- ... I datës 28.10.2010).

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi i fundit i MMPH, që i përgjigjet vendimit përfundimtar të paditurës, për rrënimin e objektit, është anuluar, vlerëson se qëndrojnë pretendimet e të paditurës se me faktin se Aktgjykimi A.nr.39/11 i datës 14.11.2013, i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, është i plotfuqishëm, rrjedh se kemi mungesë të bazës juridike të kërkesëpadsisë. Së këndejmi, gjykata vlerëson se përderisa vendimi i të paditurës Komuna e Prishtinës, për rrënimin e objektit të paditësit nuk është anuluar, apo në çfarëdo forme nuk është shpallur i kundërligjshëm, paditësi nuk posedon provë për të argumentuar veprimin e kundërligjshëm të paditurës, për veprimin dëmtues rrënimin e objektit, ashtu që nuk argumentohet as ekzistimi i fajit në shkaktimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës e aprovoi në tërësi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e refuzoi ankesën e paditësit si të pa bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ku mbi bazën e kësaj gjendje është aprovuar kërkesëpadia e paditësit.

Andaj pretendimet palës së paditësit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe të drejtë, sipas vlerësimit të këtij kolegji, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pabazuar.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon si të bazuar qëndrimin juridik të dy gjykatave të lartë përmendura lidhur me refizimin si të pa bazuar të kërkesëpadiës së paditësit, pasi që aktgjykimet e tyre në këtë çështje kontestimore, nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në revizionin e paditësit përmenden si shkak i goditjes shkeljet thelbësore procedurale, mirëpo, fare nuk është sqaruar konkretisht se cilat janë ato shkelje, andaj kjo gjykatë konstaton se janë të pa bazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale. Përndryshe, aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsyet për konfirmimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur

me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë e ka arsyetuar aktgjykimin e saj për të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura, përfshirë edhe vlerësimin për shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Në këtë kontekst aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet ankimore sa i përket shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale, ashtu që aktgjykimi i shkallës së dytë, është konform dispozitave të nenit 160 pika 4 dhe 5, të LPK-së, dispozitivi është i qartë, si dhe janë dhënë arsye të plota për mënyrën e vendosjes.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe dytë, duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, andaj edhe kjo gjykatë e pranon të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e dhënë, pasi që gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë pa mëdyshje kanë vërtetuar se e paditura kur ka vendosur dhe ka bërë rrënimin e pompës së derivateve, ka zbatuar autorizimet e veta sipas ligjit dhe nuk është gjetur se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Kështu që këto veprime janë pranuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për çështje administrative, me rastin e aprovimit të padisë së paditësit, Komunës së Prishtinës, dhe është anuluar aktvendimi i MMPH, nr. A-..., i datës 28.10.2010, me ç' rast veprimin e të paditurës të ndërmarra me vendimin nr. ..., të dt. 31.08.2010, për rrënimin e objektit, kanë mbet në fuqi, ashtu që nuk është argumentuar se veprimet e të paditurës kanë qenë të kundërligjshme që do të krijonin bazë, për kompensimin e dëmit. Kjo për faktin se aktgjykimi A.nr.39/11 i datës 14.11.2013, i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, është i plotfuqishëm, rrjedh se kemi mungesë të bazës juridike të kërkesëpadisë për këtë veprim sepse e paditura ka ushtruar funksionin e saj sipas ligjit.

Duke pas parasysh dispozitat e lartcekura, edhe Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret paditësi nuk ka bazë juridike për kompensimin e dëmit, si rezultat i rrënimeve të bëra nga ana e të paditurës, dhe pajtohet plotësisht me argumentet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë se

në këtë rast mund të ketë shkaktim të dëmit në rastin e ekzekutimit të vendimit të paditurës dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me paligjshmërinë e vendimit për faktin se vendimin e të paditurës e bëjnë të ligjshëm dispozitat e kontratës të cilat janë cekur më lart. Paditësi ka kontribuar në shkaktimin e lartësisë së dëmit, sepse nuk e ka zbatuar në mënyrë vullnetare urdhëresën për rrënimin e objekteve në mënyrë që të bëjë evitimin sa më të madh të dëmit të shkaktuar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga i autorizuari i paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr. 2/2024, datë 11.03.2024

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami